

REFLEKTIMI I DHIMBJES NË ARTIN LETRAR

Fatbardhë HASI

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Ky punim ka për qëllim të paraqesë një dukuri që është e pranishme në mbarë letërsinë. Dukuria si e tillë lidhet më krijimin e letërsisë së mirëfilltë duke marrë brumin nga realiteti i jetuar i autorëve. Një përkufizim më i qartë do të ishte *dhimbja personale e kthyer në art*. Kësaj here do të mbetemi në kufijtë e letërsisë shqipe dhe do të trajtojmë dy autorë, që janë: Ali Podrimja me librin e tij “Lum lumi” dhe Flutura Aça me përmbledhjen poetike elegji për të birin, “Roja i dritës”.

Fillimisht do të bëhet një paraqitje e strukturës së dy librave, ku do të elaborohen ndarjet në cikle të poezive të cilat paraqesin një qark kohor të shkrimit e që i lidhë e njëjta tematikë.

Studimi i dy autorëve të ndryshëm imponon një lloj analize krahasimtare, në prizmin e të cilit do të vështrohen krijimtaritë e tyre – ngjasimet dhe dallimet. Më pas, përmes metodës psikanalitike do të studiohen poezitë që kanë lidhje direkte me vetë autorët dhe po ashtu do të parashtrihen elementet biografike që zënë vend qendror në librat e trajtuar.

Kemi dy libra me temë të marrë nga jeta personale ku autorët, në kallëpin e njëjtë, atë të dhimbjes, kanë derdhur brumëra të ndryshëm. Në këta dy libra, dhimbja shfaqet dimensionalisht ndryshe-ndryshe.

Fjalë çelës: Podrimja, Aça, biri, dhimbja, realiteti, sëmundja, shpresa.

Struktura e librave

“Më jepni një dhimbje t’ju jap një kryevepër”, thënie kjo shpesh e cituar e Dostojevskit, ju rri librave që po trajtojmë, meqenëse të dy autorët kanë krijuar librat e tyre mbi bazën e një dhimbjeje që kanë përjetuar më parë.

Librat që po trajtojmë lidhen në një pikë tematike, atë të vdekjes së fëmijës. Vlen të ceket se kjo dhimbje do të paraqitet në dy këndvështrime: si e qajnë baba dhe si nëna të birin.

Kemi pra dy shkrimtarë, librat e të cilëve, përveç tema, i përaftron dhe e njëjta formë krijimi. Të dy autorët vendosin që dhimbjen e madhe me të cilën janë përballur në jetë, ta relativizojnë duke krijuar art. Ky relativizëm mund të themi se arrihet përmes një lloj terapie që në gjuhën e psikoanalistëve do të identifikohet me *kurën folëse*. Shkrimtarët përmes ligjërimit rrëfejnë dhimbjen e tyre e cila ka marrë formën e poezisë.

Është e nevojshme këtu të saktësojmë se autorët që po studiojmë janë ata të llojit të dytë, ku, sipas Frojdit, krijojnë lirshëm materialin e vet.¹

Është një realitet i përjetuar në një periudhë të caktuar kohore nga autorët, realitet ky që është bartur në krijimtari letrare përmes stilizimit gjuhësor. Dhimbja shpirtërore si derivat i një fatkeqësie të madhe, me të cilën janë kacafytur shkrimtarët tanë, u ka siguruar atyre si material i cili është transformuar në krijimtari letrare. Poezi të tëra i karakterizon një varrë e hapur që, në rastin e Podrimjes, pothuaj kurrë nuk është përtharë. Kemi parasysh faktin që, sa herë që libri ‘Lum lumi’ është ribotuar, ka ardhur i plotësuar dhe i ndryshuar nga autori. Ai, pra, asnjëherë nuk ka arritur të shkëputet nga libri i tij i dhimbjes. *Libri LUM LUMI ka mbi tri dekada që shkruhet edhe pse ka përjetuar disa botime. Idetë, mesazhet, figuracioni dhe elementet e tjera shprehëse më kanë nxitur t’u rikthehem disa poezive...*²

I ndarë në katër cikle, libri përbëhet nga poezi që kanë tematikë kryekreje sëmundjen dhe vdekjen e Lumit, mirëpo aty janë përfshirë edhe

¹ Frojdi, tek eseja *Poeti dhe fantazia*, ka folur për dy lloje të shkrimtarëve: 1. Autorët antikë të poemave epike dhe të tragjedit, që përdorin material të krijuar më parë; dhe 2. Shkrimtarë që duket se krijojnë lirshëm materialin e vet. Cituar sipas: (Sigmund Freud, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 23.)

² *Shpjegimi i dhembjes sime*, shkrim nga Ali Podrimja i shkruar më: 15.01.2003. Cituar nga: Ali Podrimja, *Lum lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 7.

shumë poezi që dalin jashtë atij qarku tematik. **A do të ketë kohë; Të jetosh; Të keqeno; Pastërri njerëzore** - janë emërtimet e cikleve me poezi që përbëjnë strukturën e librit “Lum lumi”³. ‘*Të jetosh*’, është më i bukuri poetikisht e më i rëndi tematikisht.⁴ Aty Podrimja ka paraqitur periudhën jetësore me sëmundjen e Lumit deri në shuarjen e tij nga jeta, si dhe mundimet pas shkuarjes së Lumit.

Libri “Roja i dritës”⁵ është përmbledhje me poezi të cilan autorja Flutura Aça ka shkruar para, gjatë dhe pas humbjes së djalit. Libri është i ndarë në katër cikle, të emëruara në latinisht: **initum, terminus, estensio, spiritus** dhe **ventus**. Në fillim të librit hasim në dedikimin: “Sërish për Jerin”, pra libër dedikuar djalit të saj të humbur, ashtu siç hasim edhe te libri i Podrimjes dedikimin: “Dhembjes sate Lumi, Babi”.

Pjesa e fundit e librit “Roja i dritës”, e titulluar Spiritus ventus, përbëhet nga një poezi e vetme dhe një përshkrim rreth asaj poezie nga vetë autorja. Aça ka vendosur që librin e saj ta përmbyllë me poezi të një autoreje të re (mikeshë e djalit të autores), e cila poezinë ia kushton birit të saj. “Mos u dashuro kurrë në një burrë që po vdes”. Poezia është në dy gjuhë: në gjuhën angleze, e shkruar nga Courtney Elisabeth Macaulay dhe e përkthyer në shqip nga autorja Aça.

Personalja e transformuar në art – Ali Podrimja

Një element që i nxit gjithmonë studiuesit të hulumtojnë në krijimtari letrare, është gjetja e elementeve biografike dhe lidhja e tyre me jetën e autorit.

Rasti i librave që kemi në shqyrtim, e kanë të shprehur qartë elementin biografik, të dëshmuar me argumente e data. Studiuesit, librin e Podrimjes e kanë pozicionuar tamam libër biografik të autorit. *Tradita tridhjetë vjeçare e leximit të kësaj vepre, paprerë e ka parë atë në kontekstin personal e nën shenjat e së vërtetës së jetës së Podrimjes. Tema e rëndë dhe fare personale e literaturës leximin e tillë e ka lidhur me biografinë, që, vërtet, është një lidhje më kontekstin personal të autorit,*

³ Në pamundësi për të siguruar një kopje nga botimi i parë i librit, në këtë punim do t'i referohemi botimit të dytë me plotësim, i cili është publikuar më 1986 nga Rilindja, Prishtinë.

⁴ Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, f, 105.

⁵ Flutura Aça, *Roja i dritës*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2018.

pa e zbritur në lexime sociale e ideologjike⁶ – ka argumentuar studiuesi Shala.

Në anën tjetër, studiuesi Krasniqi ka pohuar se: *poezia tashmë shndërrohet në dëshmi direkte të vuajtjes shpirtërore.... Lum Lumi e fokuson dhembjen në personen autoriale duke e vënë në krizë vetë konceptin e Eliotit për personalen dhe impersonalen poetike*⁷. *Ali Podrimja arrin fuqishëm që personalen ta shndërrojë në impersonale, okazionin në universalitet dhe fenomenin e poezisë ta identifikojë fuqishëm me dhembjen njerëzore...*⁸

Poezia e Podrimjes përfshin një periudhë kohore që nga zbulimi i sëmundjes së djalit, rrugëtimi dhe ballafaqimi me sëmundjen, përpjekjet për shërimin e tij, për ta mbyllur me humbjen e Lumit, mungesën, dhimbjen dhe sfidën e të mësuarit për të jetuar pa të. Këtë linjë kohore e bëjnë më të identifikueshme datat në fund të secilës poezi, që orientojnë lexuesin në kontekstin kohor.

Te poezia *Fletë e bardhë* kemi të dhënë datën se kur Lumi përfundimisht e ka humbur betejën me sëmundjen e tij. Poezia *Fletë e bardhë*, pra vjen si poezi pas vdekjes së Lumit, sepse është shkruar në tetor të 1982-ës, kurse brenda poezisë mësojmë datën e vdekjes së Lumit:

Mbi tavolinë

Fletë e bardhë Aty do shkruar:

Lum Podrimja vdiq me 29 shtator 1982

*Por unë nuk mund ta nënshkruaj vdekjen tënde*⁹

Poeti refuzon të pajtohet me vdekjen e djalit, ai refuzon të nënshkruajë vdekjen e tij, nuk pajtohet, revoltohet para një akti funebër dhe të pakthyeshëm.

Vdekja ishte me e shpejtë dhe Zbrazësia, janë poezi të shkruara pas vdekjes së Lumit, në të cilat shpërfaqet gjendja jo vetëm e autorit, por edhe e gjithë rrethit familjar, pjesë e asaj tragjedie.

⁶Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, f. 105.

⁷Eliot në esenë e tij, *Tradita dhe talenti individual*, ishte shprehur se: emocionin artistik është impersonal edhe poeti nuk mund të arrijë këtë impersonalitet po që se nuk i dorëzohet plotësisht veprës që ka përpara.

⁸Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99 – AIKD, Prishtinë, 2016, f. 463.

⁹Ali Podrimja, *Lum lumi*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 75.

*Ishe larg shumë larg Lumi
Këmbët më ranë bërrylat m'u përgjakën
Duke të ndjekur*

*Tash je larg tepër larg
Vdekja ishte më e shpejtë se unë
(Vdekja ishte më e shpejtë)*

*Pas vdekjeve të papritura në Familjen tonë
Miq të filluan të na vizitonin më shpesh
Nga Evropa të na sjellin: Betovenin Mozartin
Shopenin
Por ç'na duhet kur as gramafoni s'dëgjohej më
E ne humbëm ndjenja edhe për vallëzim edhe për
muzikë*

(Zbrazësia)

Poezitë: *Pikëllim; Me jetue; Tabela 9; Ekzistenca; Tabela e 80; Në dhomën e vdekjes; Rrenë kulluqe; Nuk kam bërë kurrgjë për Lumin* janë poezi që i takojnë etapës kohore para vdekjes së Lumit.

Për nga dhimbja, ndjenja e fajit dhe brenga, këto poezi janë më të rënda sepse konteksti emocional brenda tyre është i dukshëm. Nëse te poezia *Me jetue* Podrimja i referohet të birit vetëm me këshilla se si të jetojë dhe të veprojë, ku edhe pavetëdijshëm ndërtohet një lloj *arketipi i babës*¹⁰, në poezinë *Ekzistenca* kemi një frymë krejtësisht ndryshe. Aty e vetmja gjë e rëndësishme është *ruajtja e peshës*, kusht i domosdoshëm ky që Lumi t'i bëjë ballë sëmundjes. Por i biri trashëgon kokëfortësinë nga baba:

*Shpesh na kthen shpinën me inat prish qetësinë
Por unë e di: Ti je zorrë qorre kahmoti
Enigmatik rri vazhdimisht
sgjë te ti nuk shpie na i fsheh gjurmët...*

(Ekzistenca)

¹⁰ Sipas Jungut, arketipi i babait formon një figurë autoriteti që drejton pavetëdijen e individit se si të jetojë bazuar në shembullin e tij. (<https://sq.warbletoncouncil.org/arquetipos-carl-gustav-jung-3089>, WARBLETONCOUNCIL, *Arketipet sipas Carl Gustav Jung*. Qasja për herë të fundit, datë: 26.02.2022.) Ani pse arketipi i babait paraqitet edhe si: figura e babait pandjenja, Ali Podrimja ndjen dhe vuan për fatin e të birit, pavarësisht që disa poezi të krijojnë mendimin e kundërt kur ndjehet fryma vetëqortuese.

Koha e trajtimit të sëmundjes së Lumit është paraqitur në poezitë: *Tabela 9, Tabela e 80, Në dhomën e vdekjes.*

Te *Tabela 9*, trajtimi i sëmundjes së Lumit është në fazën kur terapia kërkon shumë forcë dhe durim. Prandaj nga gjoksi i poetit lëngojnë vargjet:

Kohë dhe durim

Fitojnë vetëm ata me nerva konop.

(Tabela 9)

Te *Tabela e 80* përmbysen të gjitha shpresat, sepse kjo terapi është me e rënda, ajo që ia determinon fatin Lumit: *ose ta mundësh ose të mund.*

Ndjenjën e fajit për pamundësinë e të bërit më tepër për të birin Podrimja e ka shprehur në poezinë *Nuk kam bërë kurrë për Lumin*. Kjo poezi përmbledh në vete disa realitete. Fillimisht na shfaqet natyra dhe karakteri i poetit, relacioni i tij me të birin, brengat e të cilit nuk i ka dëgjuar kurrë deri në fund. Më pas kemi të dhënë karakterin dhe personalitetin e Lumit, periudhën e sëmundjes së Lumit, revoltimin e fëmijëve të tjerë ndaj babait për mosveprimin e këtij të fundit dhe, në fund, paraqitjen në zi të nënës së Lumit. Poezia përmbillet më vdekjen e Lumit. Janë pra disa pamje në situata të ndryshme që Podrimja ka arritur t'i përfshijë brenda një poezie.

Të gjitha poezitë përmbajnë në vete realitete të jetës së autorit, realitete të cilat autori i ka përjetuar me dhimbje formash të ndryshme. Poezia e Podrimjes është derivat i një gjendjeje personale të jetuar në një kohë relativisht të shkurtër para publikimit të poezive. Është një luftë psikike kjo e autorit në një rrethanë të veç antë, ballafaqimi me humbjen e madhe që ka përjetuar. Ai ka arritur që dhimbjen e tij ta metamorfizojë në art. Podrimja me krijimin e tufës së tij poetike ku shpërfaq dhimbjen për të birin, ka arritur ta relativizojë dhimbjen personale duke e ndarë atë me të tjerët.

Arti si derivat i dhimbjes – Flutura Aça

Flutura Aça e ka latuar dhimbjen e saj prej nëne duke e transformuar në poezi. Poezia e saj rënkon nga dhimbja dhe malli. Subjektin e saj, të cilit ia dedikon poezinë, ajo e ngre në eter, duke i thurur himnet me

të lavdishme. Ajo krijon figurën e të birit duke e përshkruar me fjalët më të brishta, ledhatare dhe madhështore. Ajo e bën atë të duket i madhë-rishëm sa lexuesit i krijon përshtypjen e përshkrimit të një hyjnie. Në këtë frymë është krijuar poezia “Gjysmëfjetur”:

Sa t' du!
Portreti më i bukur që dizajnoj natyra,
shpirti më i ngjyrtë që preku bryma,
ecja më e bukur që ndërtoj hapi,
retina më e qashtër që njomi loti,
materien time ke hijeshu.
(Gjysmëfjetur)

Në të njëjtën frymë gufojnë edhe poezi të tjera, ku dashuria deri në përjetësi e nënës për të birin është portretizuar në strofë, varg, fjali e fjalë. Kujtojmë vargjet:

pse ishe ti,
ashtu, siç ishe,
i mirë deri në pafundësi,
o, Bir!

Himnizimi në superlativ është realizuar në poezinë “Roja i dritës”. Te kjo poezi autorja ka arritur të shfaqë fuqishëm shëmbëlltyrën e dashurisë prej nëne, e cila përmes fjalës artistike krijon himnin e pavdekshëm për humbjen e të birin.

Ti kishe kaq qiell brenda teje,
Sa edhe dielli bante ndejë n'tandin sy,
E drita xhelozohej kur fikej mramjeve,
Horizonti ankohej,
Se s'mundej me të ngja ty.
(Roja i dritës)

Digjitalizimi i ditëve të sotme na jep shumë mundësi që të qasemi në jetën private të autorëve. Një arritje e tillë i ka mundësuar lexuesit të ketë qasje edhe në tragjedinë e ndodhur në jetën e shkrimtares Açka. Duke filluar nga profili i saj zyrtar në facebook, ku ajo është aktive, më pas intervistat e dhëna në portale dhe në emisione televizive e deri te

romani biografik,¹¹ i botuar kohëve të fundit, krijojnë mundësi që të mbledhim fakte reale me referenca të besueshme nga jeta e shkrimtares që, më pas, të tërhiqen paralele biografike me veprën letrare.

“Roja i dritës” është përmbledhje e poezive që janë shkruar për rreth tri vjet. Këtë e dëshmojnë datat në fund të poezive. Pjesa më e madhe e poezive janë shkruar në vitin 2018, vit ky fatal në jetën e shkrimtares.

Pjesa e librit që përmban ndjeshmërinë dhe vuajtjen më të madhe, është titulluar: **Estensio**. Të gjitha poezitë në këtë pjesë i takojnë periudhës pas vdekjes së Jerit (djalit të Flutura Açkës). Cikli fillon më distikun që shpreh qartë mosbindjen e shkrimtares për ta pranuar faktin që i biri nuk është më:

*Më thonë se ke ikur, por
s’kanë fuqi për t’ më bindur...*

dhe përfundon me poezinë *Këpucët*, ku pranimi i realitetit të dhimbshëm bëhet në mënyrë aq madhështore me një estetikë krijuese të stërholluar e që shfaqet hapur në strofën e fundit:

*Këpucët,
si shumë sende pa vlerë,
orendi tani,
kanë jetë më të gjatë se ti.
(Këpucët)*

Jeri nuk arrin ta jetojë urimin të cilin është traditë të thuhet kur zakonisht blihen këpucë të reja: “i bartësh me shëndet dhe i shqefsh”, prandaj edhe metafora e jetëgjatësisë së këpucëve e bën këtë poezi kaq të thellë e mallëngjyese.

Ta kthesh dhimbjen në art që kapërcen kufijtë e të ndjerit subjektiv, është sfidë dhe nuk arrihet shpesh në letërsi. Por, metafora e ndërtuar në katër vargje, e cila është krijuar vetëm dy ditë pas tragjedisë së Açkës, dëshmon se, edhe pse rrallë, nuk është e pamundur:

Më zhbëri dhimbja,

¹¹ Flutura Açka, *Biri*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2020.

*Tani jam gur,
Dhe bëj çfarë bën guri.
Duron.*¹²

7 maj 2018¹³

Dy etapa tjera kohore në poezitë e Flutura Ačkës, janë: e para, koha e sëmundjes së birit dhe përballja më të, kurse e dyta, ajo pas pranimit të vdekjes së të birit, të cilin mund ta quajmë si *pranimi i dhimbshëm*.

Në etapën e parë zotëron dhimbja, e cila, sado e madhe që është, është e përballeshme, *fija e shpresës* për shërim. Etapa e dytë shoqërohet me kujtime dhe pranimin e dhimbshëm të realitetit. Vazhdimi i një *jetese zori* është portretizuar në poezinë: *Të shtunat e mia*:

(...)
*Të shtunat e mia,
presin veç orën e meshës,
çastin e faljes,
të takimit me supremin yll,
që regetin kujtesës,
që vjen e më vesh sërish,
me aureolë të përdritërt,
të mbijetesës,
gjer të shtunës tjetër.
(Të shtunat e mia)*

Të zbusësh dhimbjen duke e ndarë me të tjerët përmes artit, ky do të ishte një përkufizim i qëndrueshëm për dy autorët që trajtuam kur kemi parasysh *kurën folëse* të Frojdit?

Përfundim

Qëllimi i punimit i cili na cyti të merremi me këta dy autorë mund të pohojmë se është realizuar kur kemi parasysh përmbajtjen e punimit, idenë e realizimit, metodat e aplikuara dhe rezultatet e nxjerra.

¹² Flutura Ačka, *Roja i dritës*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2018, f. 68.

¹³ Djali i Ačkës ka vdekur më 5 maj të vitit 2018 (referuar nga libri *Biri*, Flutura Ačka, Skanderbeg Books, Tiranë, 2020, f. 12.).

U pa që të dy poetët kanë një temë që i përafron. I rëndësishëm është fakti se si është trajtuar e njëjta temë nga dy botë të ndryshme, bota e burrit dhe e gruas, si është përjetuar dhimbja nga babai, e si nga nëna, si vajton baba të birin, e si nëna.

Një dhimbje që godet fuqishëm njëlloj të dy prindërit, por që përjetohet ndryshe-ndryshe.

Poezitë e Podrimjes, përveç dhimbjes, brengës, mallit, dëshpërimit, i përcjell edhe një ndjenjë faji dhe vetakuzimi rreth pamundësisë për të bërë aq sa duhet për të birin. Akuza është e hapur nga vetë autori për vetveten. Ndihet fryma e një gjykimi dhe akuzimi personal që autori e mban mbi supe e që, jo rrallë, i zë frymën.

Në anën tjetër, në poezinë e Ačkës kemi dhimbjen që ther vazhdimisht, nuk ka vetakuza, nuk ka ndjenjë faji, por ka mosbindje ndaj fatit të paracaktuar. Ka revoltë për padrejtësitë jetësore, për absurditetin e thyerjes së ligjit të procesit jetësor. Janë këto të përbashkëtat dhe dallimet mes dy autorëve.

Mënyra e ndërtimit të poezive ngjason me një rrëfim çlirues, autorët kanë hapur zemrën, andaj rrëfimi i tyre është identifikuar si një *kurë folëse*.

Literatura

Ali Podrimja, *Lum lumi*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

Ali Podrimja, *Lum lumi*, Koha, Prishtinë, 2012.

Flutura Aça, *Roja i dritës*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2018

Flutura Aça, *Biri*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2020

Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017.

Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99 – AIKD, Prishtinë, 2016.

Sigmund Freud, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria

T.S. Eliot, *Ese të zgjedhura*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

<https://sq.warbletoncouncil.org/arquetipos-carl-gustav-jung-3089>,
WARBLETONCOUNCIL, *Arketipet sipas Carl Gustav Jung*.

REFLECTION OF PAIN IN LITERARY ART

Summary

The purpose of this paper which prompted us to give our opinions on these two authors will have been fulfilled when we take the content of the paper, the idea of realization, the methods applied and the results obtained in consideration.

Both poets addressed a topic which has brought them together. It is of great importance how the same topic is addressed from two different perspectives, the perspective of men and women.

The way a father experiences pain of child loss, and the way a mother does the same. How a father mourns his son, and the way how a mother mourns the same loss.

A pain that strikes both parents equally but is experienced differently.

Podrimja's poems, in addition to pain, sorrow, longing, despair, also conveys a sense of guilt and self-blame about the inability to do more for his son. The author is accusing himself. The spirit of a personal judgment and accusation that the author carries on his shoulders and that often takes his breath away can be felt.

On the other hand, in Ačka's poetry we have the pain that is constantly stabbing. There are no self-accusations, there is no guilt, but there is disobedience to the predestined fate. There is revolt for the injustices of life, for the absurdity of breaking the law of the process of life. These are the similarities and differences between the two authors.

The way the poems are constructed resembles a liberating narrative, the authors have opened their hearts, hence their narrative has been identified as a talking cure.

Both collections of poetry give to Albanian poetry the example of how it has been achieved that the personal is transferred to literary art. Embroidery of pain with aesthetic words is the best definition.

